REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 324/20
Datë/Datum. 26.06.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH .nr.324/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi – Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Urban Invest" SH.P.K - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me jelek reflektues dhe dorëza-Ritender 1" me nr. të prok: "214-19-9532-1-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Policia e Kosovës, më datën: 25.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Urban Invest" SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me jelek reflektues dhe dorëza-Ritender 1" me nr. të prok: "214-19-9532-1-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Policia e Kosovës.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me jelek reflektues dhe dorëza-Ritender 1" me nr. të prok: "214-19-9532-1-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Policia e Kosovës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Urban Invest" SH.P.K – Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Urban Invest" SH.P.K – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.05.2020 me nr.324/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me jelek reflektues dhe dorëza-Ritender 1" me nr. të prok: "214-19-9532-1-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Policia e Kosovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 59.2, 59.4 dhe 60.1.1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 4 pika 4.4 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 15.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje të pretendimin nr. l
Lidhur me pretendimin e parë ankimor të OE pretendon se "...dallimi tek shkronjat POLICE për Imm dhe 4 mm te cilat edhe nuk mund të vërehen në dukje të lirë mund të kuantifikohet lehtë gjatë prodhimit dhe nuk do të duhej të ishte arsye për eliminim...", sqarojmë se kërkesë e dosjes ka qenë që: "Kërkesa 2 Operatorët Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë nga një mostër për secilin artikull sipas specifikacioneve teknike".
Vlen të theksohet se AK për këtë specifikacion teknik ka lejuar një tolerancë rreth 10%, kur kanë potencuar "...madhësia e shkronjave mbrapa duhet të jetë 8-9 cm", me gjithë këtë OE ankues (bazuar në vet ankesën e tij nr.324/20) nuk ka arritur të ofroj mostër brenda tolerancës së caktuar nga AK.

Sa i përket pretendimit rreth materiali të jelekut, ku AK ka konstatuar se në vend të peshës 130-150 gram / lm2, OE ankues ka ofruar material prej 190 gram/lm2, OE pretendon se "...jemi kujdesur që prodhuesi të ofrojë gramazhën e njejtë dhe të njëjtën na e ka konfirmuar, kurse AK nuk ka dëshmuar se si e ka bërë këtë matje pasi matjet e tilla bëhen vetëm nga laborator të certifikuar e jo në ndonjë mënyre tjetër", konsiderojmë se pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Vlen të theksohet se për këtë aktivitet të prokurimit OSHP me datë: 24.04.2020, ka marrë vendim me nr. 152/20, në arsyetim të cilin vendim thuhet:

"Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve dorëzat nuk i përmbajnë specifikat teknike sikurse është kërkuar në dosje të tenderit. Po ashtu, edhe tek kërkesa që ka të bëjë me listën e kontratave, fletë dërgesë, faturë, etj. AK duhet që të sigurohet se OE i rekomanduar për kontratë i posedon.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht e obligon autoritetin kontraktues se gjatë ri- vlerësimit të ofertave të veproj konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, si dhe të vlerësoj drejt ofertat e operatorëve ekonomik ".

Përgjigje në pretendimin nr.2

Sa i përket pretendimit ankimor kundrejt OE tjetër ofertues ku OE ankues deklaron se: nuk e ka vazhduar Sigurimin e Tenderit duke u treguar i papërgjegjshëm dhe qëllim keq vetëm për ta vonuar këtë aktivitet prokurimi".

Sqarojmë se ky pretendim ankimor është pretendim sugjestiv i OE ankues dhe eksperti shqyrtues në çfarëdo mënyre e ka të pamundur të konfirmoj ose mohoj një pretendim të tillë ankimor.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart vlerësojmë se gjatë procedurës së rivlerësimit AK ka vepruar në pajtim me vendimin e PSH nr. 152/2020.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së njoftimi për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 18.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 16.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020 pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit

për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Urban Invest" SH.P.K – Prishtinë, se "...dallimi tek shkronjat POLICE për Imm dhe 4 mm të cilat edhe nuk mund të vërehen në dukje të lirë mund të kuantifikohet lehtë gjatë prodhimit dhe nuk do të duhej të ishte arsye për eliminim...". Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes të tenderit ka qenë që: "Kërkesa 2 Operatorët Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë nga një mostër për secilin artikull sipas specifikacioneve teknike". Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues për këtë specifikacion teknik ka lejuar një tolerancë rreth 10%, kur kanë potencuar ".. madhësia e shkronjave mbrapa duhet të jetë 8-9 cm", me gjithë këtë OE ankues (bazuar në vet ankesën e tij nr.324/20) nuk ka arritur të ofroj mostër brenda tolerancës së caktuar nga AK. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Urban Invest" SH.P.K – Prishtinë, rreth materiali të jelekut, ku AK ka konstatuar se në vend të peshës 130-150 gram / lm2, OE ankues ka ofruar material prej 190 gram/lm2, ndërsa OE pretendon se "...jemi kujdesur që prodhuesi të ofrojë gramazhën e njëjtë dhe të njëjtën na e ka konfirmuar, kurse AK nuk ka dëshmuar se si e ka bërë këtë matje pasi matjet e tilla bëhen vetëm nga laborator të certifikuar e jo në ndonjë mënyre tjetër", Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.
Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit OSHP ka marrë vendim PSH.nr.152/20, i protokolluar me datë: 24.04.2020, në të cilin thuhet:
"Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve dorëzat nuk i përmbajnë specifikat teknike sikurse është kërkuar në dosje të tenderit. Po ashtu, edhe tek kërkesa që ka të bëjë me listën e kontratave, fletëdërgesë, faturë, etj. AK duhet që të sigurohet se OE i rekomanduar për kontratë i posedon. Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht e obligon autoritetin kontraktues se gjatë ri- vlerësimit të ofertave të veproj konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, si dhe të vlerësoj drejt ofertat e operatorëve ekonomik ".

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Urban Invest" SH.P.K – Prishtinë, kundrejt OE tjetër ofertues ku OE ankues deklaron se: nuk e ka vazhduar Sigurimin e Tenderit duke u treguar i papërgjegjshëm dhe qellim keq

vetëm për ta vonuar këtë aktivitet prokurimi". Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimorë është pretendim sugjestiv i OE ankues dhe eksperti shqyrtues në çfarëdo mënyre e ka të pamundur të konfirmoj ose mohoj një pretendim të tillë ankimorë. Andaj bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se gjatë procedurës së rivlerësimit autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me vendimin e PSH nr. 152/2020 i protokolluar me datë: 24.04.2020.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e ekspertit shqyrtues dhe në bazë të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë në harmoni me nenin 62 të LPP-së sepse autoritetet kontraktuese duhet të konsiderojnë ofertën e një OE si të përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Policia e Kosovës

1x1 OE -"Urban Invest" SH.P.K – Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.